

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, Departamenti i Përgjithshëm ,Divizioni Civil, gjyqtari Alban Beqiri, me sekretaren juridike Lendita Pajaziti, në çështjen juridike të paditësve [REDACTED] dhe [REDACTED] i që të dy nga Ferizaj Rr.“ [REDACTED]” nr. [REDACTED], të cilët i ka përfaqësuar me autorizim Av. [REDACTED] kundër të paditurit [REDACTED] ish nga Ferizaj Rr.“ [REDACTED]” nr. [REDACTED], tani me adresë të panjohur të cilin e ka përfaqësuar përfaqësuesja e përkohshme av. [REDACTED] nga Ferizaj, në çështjen juridike vërtetim i pronësisë, pas seancës kryesore publike të mbajtur më 15.11.2016 në prezencën e të autorizuarit të paditësve dhe të përfaqësueses së përkohshëm të paditurit, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I APROVOHET kërkesë padia e paditësve [REDACTED] dhe [REDACTED] i që të dy nga Ferizaj Rr.“ [REDACTED]” nr. [REDACTED] e paraqitur kundër të paditurit [REDACTED] ish nga Ferizaj Rr.“ [REDACTED]” nr. [REDACTED] tani me adresë të panjohur, **si e bazuar.**

II VËRTETOHET se paditësit [REDACTED] dhe [REDACTED] nga Ferizaj janë pronarë secili me nga 1/2 të pjesë ideale të paluajtshmërisë dhe atë NK.nr.01011/8 me sipërfaqe prej 828m² vendi i quajtur “Arat e Tullave” e cila evidentohet ne fletë poseduese nr. 950 ZK Ferizaj.

III DETYROHET i padituri [REDACTED] që t’ia pranoj paditësve të drejtën e pronësisë, dhe t’ia bartë në emrin e tyre në afat prej 15 ditësh, në të kundërtën pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, ky aktgjykim, paditësve do t’iu shërbej si dëshmi tabulare për bartjen e pronësisë në librat kadastral të Drejtorisë për Pronë, Gjeodezi dhe Kadastër të Komunës së Ferizaj, pa prezencën e të paditurit.

IV DETYROHEN paditësit që solidarisht të paguajnë shpenzimet e procedurës në shumë të përgjithshme prej 100 € në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit me dhunë.

A r s y e t i m

I autorizuari i paditësve Av. [REDAKTUAR] në fjalën e tij ka deklaruar mbetëm në tërësi pranë padisë dhe kërkesëpadisë, duke shtuar se nga provat e administruara dhe atë kontrata e lidhur në mes nënës së paditësve dhe të paditurit e dt.16.01.1967, u vërtetua se nëna e paditësve tani e ndjerë, [REDAKTUAR] e ka blerë nga i padituri [REDAKTUAR] fillimisht me anë të kësaj kontrate e ka blerë sipër 6 ari nga i padituri, kurse në ndërkohë e ka blerë edhe pjesën tjetër prej 2 ari e 28 m² nga i njëjti e që tërë sipërfaqe e blerë përputhet me sipërfaqe që evidentohet me NK.nr.01011/8 me sipër. prej 828 m², e cilën e ka paguar në tërësi si dhe ka filluar që ta shfrytëzon e të cilën e ka në mirëmbajtje dhe shfrytëzim të pa penguar nga askush e as nga i padituri apo ndonjë familjar i tij.

Me rastin e daljes së gjykatës në vendin kontestues u vërtetua se paditësit e kanë këtë paluajtshmëri në shfrytëzim ku i kanë edhe të ndërtuar shtëpitë e tyre të cilat banojnë s'bashku me familje.

Andaj nga provat e administruara dhe dëgjimin e dëshmitarëve u vërtetua se e ndjera ka blerë këtë pronë fillimisht sipër prej 6 ari ku shihet edhe nga kontrata e lidhur me dt.16.01.1967 nga i padituri, në ndërkohë edhe pjesën tjetër prej 2 ari e 28 m² e ndaj të cilit është përmbushur në tërësi detyrimi kontraktues, ka kërkuar nga ana e gjykatës që ta aprovoj në tërësi padinë dhe t'iu njoh paditësve të drejtën e pronësisë secili nga 1/2 pjesë ideale, të NK.nr. 01011/8 me sipër të përgjithshme prej 828 m².

Nuk i ka kërkuar shpenzimet e procedurës.

Përfaqësuesja e përkohshme e të paditurit [REDAKTUAR] av. [REDAKTUAR] në fjalën e saj ka deklaruar se në bazë të provave të administruara, daljes së gjykatës në terren me ekspertin e gjeodezisë për identifikim e ngastrës kadastrale që është objekt i këtij kontesti, ka theksuar se këto prova përputhen me gjendjen faktike të kësaj paluajtshmërie, kurse pas dëgjimit të dëshmitarëve u vërtetua se paraardhësja e paditësve në vitin 1967 kishte lidhur kontratë mbi shitblerjen e kësaj paluajtshmërie, me pronarin juridik të kësaj paluajtshmërie, dhe që nga ajo kohë të njëjtës i është dorëzuar në posedim dhe shfrytëzim paluajtshmëria në fjalë.

Ka theksuar se në bazë të kësaj janë përmbushur kushtet ligjore që gjykata të merr aktgjykim meritor në lidhje me kërkesë padinë e paditësve.

Kurse sa i përket shpenzimeve të procedurës ka deklaruar se meqenëse paditësit ia kanë përmbushur detyrimet ndaj saj nuk i ka kërkuar shpenzimet e procedurës.

Gjykata për të vërtetuar drejtë gjendjen faktike në këtë çështje juridike kontestimore në procedurën e provave sipas propozimit të palëve bëri administrimin e këtyre provave: U lexua padia C.nr.489/11 dt.23.09.2011, kontrata e lidhur në mes blerësit [REDAKTUAR] dhe shitësit [REDAKTUAR] dt.16.01.1967 përpiluar tek avokati [REDAKTUAR] në gjuhën serbe, certifikata pronësore me nr. 00950 dt.19.09.2011, parashtrësia e të autorizuarit të paditësve dt.02.03.2016 për rregullimin e padisë në kuptimin subjektiv, certifikata e vdekjes për [REDAKTUAR] nr. rend. 1879 nr. ref.19/2014 RV/19001 dt.02.03.2016 (fotokopje), autorizimi i paditësve dhënë av. [REDAKTUAR] dt.01.03.2016, aktvendimi i Gjykatës Themelore në Ferizaj C.nr. 489/11 dt.03.03.2016, parashtrësia e të autorizuarit të paditësve dt.08.03.2016 për vazhdim të procedurës, dëshmi vdekja për të ndjerën [REDAKTUAR] dt.03.03.2016, deklarata e përbashkët e fëmijëve [REDAKTUAR] [REDAKTUAR] dhe bashkëshorti [REDAKTUAR] e vërtetuar tek noteri [REDAKTUAR] nr. LRP.nr. 773/2016, aktvendimi i Gjykatës Themelore në Ferizaj C.nr. 187/16 dt.07.06.2016 me të cilën të paditurës i është caktuar përfaqësuesja e përkohshme av. [REDAKTUAR] (në tri gjuhë shqip , serbisht dhe anglisht), përgjigja në padi e përfaqësues së përkohshme të paditurës, dt.15.08.2016, autorizimi zëvendësues dhënë praktikantit [REDAKTUAR], Ekspertiza e ekspertit të gjeodezisë [REDAKTUAR] pa datë.

Bazuar në provat e administruara, vlerësimin e tyre një nga një dhe në lidhmëri me njëra tjetrën, në kuptim të nenit 8 të LPK-së gjykata ka vërtetuar se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar.

Gjykata konsideroj se nga provat e administruara, kontrata mbi shitblerjen e dt.16.01.1967, e nënshkruar nga njëra anë të paditurit si shitës dhe trashëgimlënës së paditësve-nënës si blerës, në sipërfaq prej 6 ari si dhe pjesën tjetër të blerë në sipërfaq prej 2 ari e 28 m², po nga e ndjera, e cila është vërtetua edhe nga dëgjimi i dëshmitarëve, është vërtetuar fakti se nëna e paditësve tani e ndjerë dhe i padituri kanë lidhur kontratë për shitblerjen e kësaj paluajtshmërie

dhe e njëjta është përmbushur në tërësi dhe se nga ajo kohë fillimisht e nëna e paditësit s'bashku me anëtarët e familjes dhe pas vdekjes së saj me dt.28.11.2014, të njëjtën e kanë vazhduar ta posedojnë tani paditësit të cilët e kanë në mbajtje, shfrytëzim të pa penguar nga askush dhe as nga i paditurit apo ndonjë person i tretë.

Gjykata ka gjetur se provat e administruara përputhen me gjendjen faktike të cilën gjykata e ka konstatuar me daljen në vend, me anë të ekspertit të gjeodezisë në parcelën kontestuese, ku ka vërtetuar se parcela kontestuese dhe atë në 1/2 pjesë ideale e paluajtshmërisë dhe parcelën kadastrale nr. 1011/8 me sipërfaqe prej 828m² e cila evidentohet në fletë poseduese nr. 950 ZK Ferizaj, kjo sipërfaqe përputhet me sipërfaqen në kontratë dhe me pjesën tjetër të blerë nga nëna e paditësve e cila është vërtetua edhe me dëgjimin e dëshmitarëve ngastra kontestuese që është objekt i këtij kontesti e cila është përshkruar hollësisht në procesverbalin e daljes së gjykatës në vendin kontestues si dhe është përshkruar hollësisht nga ana e ekspertit të gjeodezisë me përkufizime përkatëse.

Gjykata me dëgjimin e dëshmitari [REDAKTUAR] vërtetoi faktin se nëna e paditësve, tani e ndjerë [REDAKTUAR] e ka blerë këtë paluajtshmëri diku rreth viteve 1967 nga një qytetar i nacionalitetit serb emri i të cilit ka theksua se nuk i kujtohet, por gjatë bisedave me prindin tim dhe raportet fqinjësore me paditësit, me sa jam informuar kontrata është përmbushur në tërësi dhe paditësja është futur në posedim në këtë paluajtshmëri ku ka ndërtuar shtëpinë për banim familjar ku dhe jetojnë edhe tani, njëherit ka shtuar se paditësja e ka blerë edhe dy ari po nga i njëjti person, vlen të theksohet se që nga viti 1963 jemi fqinjë me paditësit respektivisht nënën e tyre të ndjerë, të cilët e kanë shfrytëzuar këtë pronë në mënyrë të pandërprerë dhe të papenguar nga askush.

Dëshmitari [REDAKTUAR] ka deklaruar: se me palët ndërgjygjëse është në marrëdhënie familjare –respektivisht miq nga viti 1981, dhe se gjatë bisedave që ka pasur me paditësit dhe me prindin e tyre, deklaroi se të njëjtit këtë paluajtshmëri e kanë blerë diku rreth viteve 1967 nga një qytetar i nacionalitetit serb emri i të cilit nuk më kujtohet, dhe nga ajo kohë e shfrytëzojnë në mënyrë të pandërprerë nga askush.

Gjykata këtyre dëshmime ua fali besimin, pasi të njëjtat përputhen me provat e administruara dhe me konstatimin me rastin e daljes së gjykatës në vendin kontestues së bashku me ekspertin e gjeodezisë, ku dëshmitari [REDAKTUAR] është konstatuar se është fqinjë me paditësit nga viti 1963, ku gjatë bisedave që kishte me prindin e tij dhe raportet fqinjësore me paditësit është informuar se e ndjera ka lidhur kontratë me të paditurin në vitin 1967.

Sipas ekspertit të gjeodezisë ngastra kadastrale dhe atë konkretisht parcela kadastrale nr. 1011/8 me sipërfaqe prej 828m² e cila evidentohet ne fletë poseduese nr. 950 ZK Ferizaj, kufizohet nga veriu me ng.kad.1012-6 dhe 1012-10, nga lindja me ng.kad. 1011-3, nga jugu me rrugë të pa kategorizuar dhe nga perëndimi me NK.nr.1011-2, , në këtë ngastër ekzistojnë dy shtëpi ku në njëërën veç banojnë pronarët faktik dhe një shtëpi tjetër e ndërtuar me material të fortë dy katëshe e cila është në fazën e meremetimit, siq është konstatuar edhe me konstatimin e gjendjes faktike. Ngastra e lartpërmendur sipas shënimeve evidentohet në emër të [REDAKTUAR] [REDAKTUAR] ka një sipërfaqe prej 828 m2, ka kulturën Arë e klasës 2, gjendet në vendin e quajtur "Arat e Tullave" ZK. Ferizaj.

Gjykata meqenëse si trashëgimtarë e te ndjerës [REDAKTUAR] janë paraqitur paditësit [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR] kurse nga dëshmi vdekja e dt.03.03.2016, është konstatuar se pas vetes përveç paditësve ka lënë bashkëshortin [REDAKTUAR] dhe dy vajzat [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR] të cilët me anë të deklaratës së përbashkët të përbashkët të përpiluar dhe të nënshkruar tek noteri [REDAKTUAR] me nr. LRP.nr773/2016 me dt. 08.03.2016, kanë deklaruar se heqin dorë në favor të paditësve [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR]

Gjykata pas vlerësimit të provave lidhur me faktet ka vërtetuar se e ndjera [REDAKTUAR] nga viti 1967 ka hyrë në posedim të ligjshëm dhe me mirëbesim në paluajtshmërinë kontestuese sipas kontratës të lidhur më dt. 16.01.1967, kurse pas vdekjes së saj ky posedim i është bartur paditësve dhe nga ajo kohë të njëjtit janë në posedim të vazhdueshëm të papenguar nga askush, pra as nga i padituri.

Paditësit sipas bazës juridike të kontratës mbi shitblerjen dhe mbajtjes me mirëbesim në kuptim të nenit 28 par.1,2 lidhur me par.4 të LTHMPJ nr.6/1980, e ka fituar të drejtën e

pronësisë në parcelën kadastrale nr. 1011/8 me sipërfaqe prej 828m² e cila evidentohet në fletë poseduese nr. 950 ZK Ferizaj

Gjykata ka vlerësuar edhe thëniet e përfaqësueses të përkohshëm të paditurit e cila përmes përgjigjes në padi dhe në seancën e shqyrtimit gjyqësor e ka kundërshtuar në fillim kërkesë padinë e paditësit e ka kundërshtuar si të pa bazuar, por pas administrimit të provave, dëgjimit të dëshmitarëve, dalja e gjykatës në vendin kontestues është vërtetuar se fillimisht e ndjera ka hyrë në posedim me mirëbesim në këtë ngastre, kurse pas vdekjes paditësit ky posedim është bartur tek paditësit që konsiderohet se janë në posedim të ligjshëm dhe me mirëbesim në paluajtshmërinë kontestuese ku është bërë edhe e lidhja e kontratës më dt. 16.01. 1967 e cila është përmbushur në tërësi siç u vërtetua edhe me dëgjimin e dëshmitarëve [REDACTED] dhe [REDACTED], ku i ka propozuar gjykatës që të vendosë sipas ligjit, të cilën gjykata e vlerësoj si reale dhe në përputhje me provat e administruara.

Gjykata vendimin mbi shpenzimet e procedurës e mbështeti në nen.452.1 të LPK-së andaj paditësit obligohet që solidarisht të paguajnë shpenzimet e procedurës në shumë të përgjithshme prej 100€ për taksë gjyqësore për padi shumë prej 50 € dhe aktgjykim shumë prej 50€, meqenëse shpenzimet tjera i kanë kryer paraprakisht gjykata nuk ka vendosur lidhur me to.

Nga se u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ
C.nr.187/16 dt.15.11.2016



Gjyqtari
Alban Beqiri

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 dite, nga dita e pranimit Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.



VENDIMI ËSHITËR I QILISTRUORIT
GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

24.01 2017